

## **Programi i detajuar i trajnimit afatgjatë të kualifikimit profesional për aktuar:**

Trajnimi afatgjatë i kualifikimit profesional për aktuar do të mbulojë bazat e matematikës aktuariale, statistikës, ekonomisë dhe matematikës financiare të nevojshme për të vepruar si ekspertë në sigurimin e Jetës, sigurimit të Jo-Jetës, pensione, fonde investimi, etj. Programi gjithashtu do të shërbejë për trajnimin e pjesëmarrësve me teknikat themelore aktuariale, përgatitjen e tyre për të aplikuar këto teknika në praktikë duke u pajisur me njohuritë e fushës përkatëse dhe gjithashtu do të përgatisë pjesëmarrësit për të luajtur një rol kyç në menaxhimin financiar të kompanive të sigurimit, fondeve të pensionit dhe letrave me vlerë në kushtet aktuale dhe të ardhshme ekonomike.

Programi është i përbërë nga 14 module të listuara si më poshtë dhe secili modul quhet i përfunduar pas kalimit me sukses të testimit përkatës. Trajnimi afatgjatë i kualifikimit profesional për aktuar do të konsiderohet i përfunduar nëse pjesëmarrësit do të kalojnë me sukses të gjitha provimet për 14 modulet në total dhe do të mbrojnë një dizertacion me rreth 10,000 fjalë duke aplikuar teknika dhe metodologji aktuariale, si dhe duke përdorur materialet e studiuara në këtë trajnim së bashku me zbatimin e këtyre ideve në një situatë praktike.

Moduli 1 - Matematikë	Shtator 2015, trajner vendas
Moduli 2 - Aktivitet	Tetor 2015, IFoA (UK)
Moduli 3 - Të dhënat dhe Sistemet	Nëntor 2015, IFoA (UK)
Moduli 4 - Ekonomi	Janar 2016, IFoA (UK)
Moduli 5 - Financat	Shkurt 2016, trajner vendas
Moduli 6 - Sistemet Financiare	Mars 2016, trajner IFoA (UK)
Moduli 7 - Modelet Aktuariale	Prill 2016, IFoA (UK)
Moduli 8 - Statistikë	Maj 2016, trajner vendas
Moduli 9 - Menaxhimi i Rrezikut	Qershor 2016, IFoA (UK)
Moduli 10 - Parimet Praktika e Sigurimit të Jo-Jetës	Shtator 2016, SHASH
Moduli 11 - Menaxhimi Aktuarial i Sigurimit të Jetës	Tetor 2016, IFoA (UK)
Moduli 12 - Menaxhimi Aktuarial i Sigurimeve	Nëntor 2016, IFoA (UK)
Moduli 13 - Pensionet	Janar 2017, IFoA (UK)
Moduli 14 - Praktika Personale dhe Profesionale	Shkurt 2017, IFoA (UK)
Prezantimi dhe mbrojtja e dizertacionit	Shkurt/Mars 2017

Ky program mund të jetë subjekt i ndryshimeve në ditët në vijim.